



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË ASETVE DHE MJEDISIT

Nr. 858/4 Prot.

Tiranë, më 16/11/2020

V E N D I M

Nr.125, Datë 16.11.2020

PËR

AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, VLORË, TIRANA RURALE 1, TIRANA RURALE 2, KAVAJË, ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS DEVOLL DHE AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT, TIRANË, “MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË LËNA NË AUDITIMET E MËPARSHME”, për periudhën nga data 01.10.2019 deri më datën 30.12.2019.

Nga auditimet e ushtruara në Drejtorinë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim DVASHK) Vlorë, DVASHK Tirana Rurale 1, Tirana Rurale 2, DVASHK Kavajë, Zyrën Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Devoll dhe Agjencinë Kombëtare të Mjedisit Tiranë, rezultoi që janë rekomanduar gjithsej 255 masa, nga të cilat janë pranuar 226 masa ose 89%, si dhe nuk janë pranuar 29 masa ose 11%. Nga rekomandimet e pranuar rezultoi se janë zbatuar plotësisht 96 masa ose 42%, zbatuar pjesërisht/proces 54 masa ose 24%, si dhe 76 masa të pa zbatuara ose 33%. Megjithëse subjektet i ka pranuar pothuajse plotësisht rekomandimet e lëna në auditimet e mëparshme, niveli i zbatimit të tyre nuk është i plotë, kështu janë 161 masa organizative, nga të cilat nuk janë pranuar 23 rekomandime ose 14% e tyre dhe janë pranuar 138 masa organizative ose 86%, nga të cilat janë zbatuar plotësisht 69 masa ose 50% e tyre, janë zbatuar pjesërisht/proces zbatimi 42 masa ose 30%, dhe nuk janë zbatuar 27 masa ose 20% e tyre. Në lidhje me masat për shpërblim dëmi janë rekomanduar 24 masa shpërblim dëmi në vlerën 564,370 mijë lekë, nga të cilat janë pranuar nga 21 rekomandime në vlerën 548,637 mijë lekë ose 97% e tyre, si dhe nuk janë pranuar vetëm 3 masa në vlerën 15,733 mijë lekë ose rreth 3% e tyre. Nga masat e pranuar janë zbatuar plotësisht 8 masa në vlerën 61,519 mijë lekë, janë zbatuar pjesërisht/proces zbatimi 12 masa në vlerën 485,922 mijë lekë, si dhe nuk është zbatuar 1 masë në vlerën 1,200 mijë lekë. Në përfundim të auditimeve nga KLSH janë lënë 70 masa disiplinore, nga të cilat janë pranuar 67 masa ose 96%, si dhe pa pranuar 3 masa. Nga 67 masa disiplinore, janë zbatuar 19 prej tyre, si dhe nuk janë zbatuar 51 masa. Në përfundim kemi konkluduar se veprimtaria e subjekteve të audituara, në drejtim të çështjeve që lidhen me zbatimin e rekomandimeve, nuk ka qenë plotësisht efektive.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga grupi i auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Drejtorisë së Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë, si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30 të Ligjit nr.154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”,

VENDOSA

I. Të miratoj Raportet Përfundimtare të Auditimit “Mbi verifikimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme”, të ushtruar në 6 subjektet e audituara, për veprimtarinë 01.10.2019 deri më datën 30.12.2019.

II. Të Rikërkoj marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve për të gjitha subjektet e audituara, si më poshtë:

NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, VLORË

A. MBI REKOMANDIMET E PAPANUARA

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të kryer pranë 6 subjekteve të auditimit, u konstatua se në subjektin Drejtoria Vendore e ASHK-së Vlorë, nuk janë pranuar 12 rekomandime, për të cilat gjykojmë se duhet të rivlerësohen me objektivitet nga DVASHK Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, masat e rekomanduara, efekti që sjellin, dhe problematika që limiton zbatimin e tyre.

B. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.554/9, datë 27.12.2019, nuk janë zbatuar 14 rekomandime, si vijon:

▪ **Rekomandimi nr.7.** Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë për Lejen e Legalizimit me nr.107008, datë 08.03.2017, Lejen e Legalizimit me nr.107264, datë 20.03.2017 dhe Lejen e Legalizimit me nr.106707, datë 10.02.2017, të vendosë masë kufizimi sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, të fillojë procedurat për shfuqizimin e tyre, si dhe të njoftojë Këshillin e Ministrave dhe organet vendore për të vepruar sipas procedurave ligjore. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.8.** DVASHK Vlorë për Leje Legalizimi me nr.108076, datë 19.05.2017 dhe Leje Legalizimi me nr.106017, datë 16.05.2017, të vendosë masë kufizimi sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” dhe të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit të dhëna në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore, dhe të njoftojë subjektet për fillimin e procedurave përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.9.** DVASHK Vlorë për Lejen e Legalizimit me nr.107840, datë 03.05.2017 të vendosë masë kufizimi sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit, si dhe të njoftojë organet vendore për të vepruar në përputhje me dispozitat e Ligjit nr.9780, datë 06.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.10.** DVASHK Vlorë për Lejen e Legalizimit me nr.212502, datë 07.12.2018 dhe Lejen e Legalizimit me nr.212979, datë 28.09.2018, të vendosë masë kufizimi sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit, si dhe të njoftojë organet vendore për të filluar procedurat përkatëse. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.11.** DVASHK Vlorë të vijojë menjëherë me procedurën e kualifikimit të objekteve të ankueses E.Z. në përmbushje të dispozitave ligjore dhe nënligjore. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.12.** DVASHK Vlorë të vijojë menjëherë me procedurën e kualifikimit të objektit të shtetasit L. Gj. në përmbushje të dispozitave ligjore dhe nënligjore. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.13.** DVASHK Vlorë për 3 raste (Leja e Legalizimit me nr.108613, datë 12.07.2017, Leja e Legalizimit me nr.108895, datë 09.08.2017 dhe Leja e Legalizimit me nr.108428, datë 16.06.2017), të vendosë masë kufizimi sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën”, të

fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes së legalizimit, si dhe të njoftojë organet vendore për marrjen e masave për katet që janë ngritur më tepër nga ç'lejojnë planet vendore. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.14.** DVASHK Vlorë për Lejen e Legalizimit me nr.108119, datë 24.05.2017, të vendosë masë kufizimi sipas kërkesave të ligjit nr.111/2018 “Për Kadastrën” si dhe të fillojë procedurat për shfuqizimin pjesor të lejes së legalizimit për pjesën e ndërtimit që është dhënë më tepër nga dokumentacioni tekniko-ligjor. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.17.** DVASHK Vlorë të marrë masa, të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko-ligjor mbi bazën e të cilit janë lëshuar lëshuar Leje legalizimi nr. 108824, datë 01.08.2017, Leje legalizimi nr. 108105, datë 19.06.2017 dhe Leje legalizimi nr. 108547, datë 04.07.2017 dhe shfuqizimin e lejeve të legalizimit të mësipërme. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.18.** DVASHK Vlorë të marrë masa të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko-ligjor mbi bazën e të cilit është lëshuar leja e legalizimit nr. 105651, datë 03.02.2017 dhe shfuqizimin e kësaj leje legalizimi. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.19.** DVASHK Vlorë të marrë masa, të vendosë masë kufizimi dhe të fillojë procedurat me grup pune për rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko-ligjor mbi bazën e të cilit është lëshuar leja e legalizimit nr. 108557, datë 05.07.2017 dhe shfuqizimin e kësaj leje. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.20.** DVASHK Vlorë, në 43 raste, të marrë masa që pas miratimit me VKM të parcelave ndërtimore, për çdo rast, sipërfaqja e parcelës ndërtimore e përfituar më tepër, të likuidohet me çmimin e tregut nga personat përfitues, në të kundërt kjo sipërfaqe të kthehet në gjendjen juridike të mëparshme (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”, bashkëlidhur). (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.21.** DVASHK Vlorë referuar dokumentacionit që ndodhet në dosjen me referencë nr. 2347, të rivlerësojë masën, për heqjen e kufizimit ndaj pasurisë nr. 18/190, volum 18, faqe 106, ZK 8601, Qyteti Vlorë, pasi dokumentacioni përkatës për fitimin e pronësisë, është plotësuar në përputhje me kërkesat ligjore. (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

▪ **Rekomandimi nr.22.** DVASHK Vlorë të marrë masa për kufizimin e pasurisë së përfituar sipas lejes së legalizimit nr. 108359, datë 12.06.2017 deri në paraqitjen e dokumentacionit të duhur tekniko-ligjor në lidhje me pasurinë shtetërore tjetërsuar në mënyrë të paligjshme në favor të subjektit privat duke njoftuar edhe subjektin përfitues, në të kundërt të anulojë lejen e legalizimit nr. 108359, datë 12.06.2017 (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit). (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.3) faqe (11-25) të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.Rekomandimi: DVASHK Vlorë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, për rekomandimet e pa zbatuara, të marrë masat e nevojshme, rast pas rasti, duke vendosur/hequr masën e kufizimit, dhe (ose) shfuqizimin e plotë/pjesor të lejeve të legalizimit, rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko-ligjor, zbatoj vendimet gjyqësore të formës së prerë, likuidimin e parcelës ndërtimore.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2021 dhe në vijimësi

C. TË ARDHURA TË MUNGUARA

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.554/9, datë 27.12.2019, nuk është zbatuar rekomandimi, si vijon:

▪ **Rekomandimi nr.3.** Drejtori i DVASHK Vlorë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në

dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e përfituara me Leje legalizimi (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”, bashkëlidhur), si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, deri në arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, në vlerën totale prej 15,132,700 lekë, si vlerë e trullit të përfituar padrejtësisht, nga subjektet, si më poshtë:

- H. D. Z., sipas dosjes nr. 1216/1 dhe Leje Legalizimi nr. 104197, datë 13.05.2014, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 72m², e llogaritur në vlerën 785,000 lekë;
 - A. S., sipas dosjes nr.530 dhe Leje Legalizimi nr.104278, datë 24.05.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 95m², e llogaritur në vlerën 598,500 lekë [788,500 (vlera me çmim tregu)-190,000(95*2000) (vlera e likuiduar me çmim favorizues)];
 - Z. S., sipas dosjes nr. 577/1 dhe Leje Legalizimi nr. 103876, datë 06.02.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 80m², e llogaritur në vlerën 712,200 lekë [872,200(vlera me çmim tregu)-160,000(80*2000) (vlera e likuiduar me çmim favorizues)];
 - N. Sh. A., sipas dosjes nr. 628/1 dhe Leje Legalizimi nr. 103861, datë 22.01.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër truallin me sipërfaqe 141m², e llogaritur në vlerën 1,255,300 lekë[1,537,300(vlera me çmim tregu)-282,000(141*2000)(vlera e likuiduar me çmim favorizues)];
 - Th. H. K., sipas dosjes nr. 1947/75 dhe Leje Legalizimi nr. 104004, datë 01.04.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 81m², e llogaritur në vlerën 510,300 lekë [672,300 (vlera me çmim tregu)-162,000 (81*2000) (vlera e likuiduar me çmim favorizues)];
 - N. S. D., sipas dosjes nr. 1734 dhe Leje Legalizimi nr. 103931, datë 25.03.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 118m², e llogaritur në vlerën 979,400 lekë;
 - 4 bashkëpronarët “Sinani”, sipas dosjes nr. 1901 dhe Leje Legalizimi nr. 104419, datë 27.06.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 164m², e llogaritur në vlerën 337,400 lekë[583,400(vlera me çmim tregu)-246,000(164*1500)(vlera e likuiduar me çmim favorizues)];
 - F. F. Ç. sipas dosjes nr. 10/4 dhe Leje Legalizimi nr. 104605, datë 29.06.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 169m², e llogaritur në vlerën 1,165,900 lekë;
 - Sh. I. Ll. sipas dosjes nr. 754/1 dhe Leje Legalizimi nr. 104619, datë 30.06.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 125m², e llogaritur në vlerën 1,112,900 lekë [1,362,900 (vlera me çmim tregu)-250,000(125*2000) (vlera e likuiduar me çmim favorizues)];
 - H. M. A. sipas dosjes nr. 2366/5 dhe Leje Legalizimi nr. 104397, datë 08.06.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 186m², e llogaritur në vlerën 1,171,800 lekë [1,543,800(vlera me çmim tregu)-372,000(186*2000) (vlera e likuiduar me çmim favorizues)];
 - V. M. Sh. sipas dosjes nr. 735/1 dhe Leje Legalizimi nr. 104466, datë 17.06.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër truallin me sipërfaqe 182m², e llogaritur në vlerën 1,620,300 lekë[1,984,300(vlera me çmim tregu)-364,000(182*2000)(vlera e likuiduar me çmim favorizues)];
 - E. Rr. M. sipas dosjes nr. 9 dhe Leje Legalizimi nr. 108536, datë 04.07.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 153m², e llogaritur në vlerën 1,362,100 lekë [1,668,100 (vlera me çmim tregu) - 306,000 (153*2000) (vlera e likuiduar me çmim favorizues)];
 - M. B. G. sipas dosjes nr. 190 dhe Leje Legalizimi nr. 108633, datë 04.07.2016, duke përfituar padrejtësisht më tepër, truallin me sipërfaqe 329m², e llogaritur në vlerën 3,521,600 lekë
- (Më hollësisht trajtuar në pikën (II.4) faqe (13-16) të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1. Rekomandimi: Drejtori i DVASHK Vlorë të marrë masa, në bazë të pikës 1 dhe pikës 4, neni 27 të ligjit nr. 111, datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e përfituara me Leje legalizimi (sipas tabelës “Zbatimi i ligjshmërisë për miratimin e parcelave ndërtimore”, bashkëlidhur), si dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, deri në arkëtimin e të ardhurave të munguara në buxhetin e shtetit, në vlerën totale prej 15,132,700 lekë, si vlerë e trullit të përfituar padrejtësisht, nga subjektet, e mësipërme.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.554/9, datë 27.12.2019, nuk është zbatuar rekomandimi, për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje” “Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga puna”, ndaj 10 punonjësve, si vijon:

a) **“Vërejtje me paralajmërim” deri në “Largim nga puna”, për:**

1. z. D. F., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë.
2. z. E. M., me detyrë specialist hartograf.
3. z.E. Y., me detyrë specialist i Sektorit të Çështjeve të Pronësisë.
4. zj.S. Sh., me detyrë specialiste hartografe.
5. zj. T. M., me detyrë specialiste e Sektorit të Çështjeve të Pronësisë.
6. zj. A. Rr., me detyrë specialiste hartografe.

b) **“Vërejtje”, për këta punonjës:**

1. z.A. Rr., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit.
2. z.M. J., me detyrë specialist i Sektorit të Legalizimit.
3. zj.H. K., me detyrë specialiste hartografe.
4. z. D. M., me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Hartografisë.

Për sa më sipër, për moszbatimin e rekomandimit, për dhënien e masave disiplinore punonjësve të mësipërm, mbështetur në Kreu IV, neni 11 gërma “d” dhe “e”, nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, për veprime në kundërshtim me dispozitat e Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, në bazë të nenit 9, pika 2, gërma ç e Ligjit nr.111/2018, datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, si dhe në kontratat individuale të punës, **i rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më sipër dhe marrjen e masave disiplinore.

NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, TIRANA RURALE 1 DHE 2

A. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.578/10, datë 23.12.2019, nuk është zbatuar 1 rekomandim, si vijon:

Rekomandimi nr.13. Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tirana Rurale nr.1 dhe nr.2, të marrë masa duke plotësuar arkivin e institucionit me 11 dosjet që mungojnë, sipas lejeve të legalizimit të lëshuara, bazuar dhe në rakordimin e tyre me referencat përkatëse, si më poshtë:

Nr.	Leja e legalizimit	Subjekti informal	Objekti informal i legalizuar
1.	7003362,dt.11.08.2016	“A” SHPK	Godinë ban.she shër 9 kt+2 kt nëntokë
2.	7003343,dt.07.11.2016	A. C.	Godinë shërbimi 2 kat
3.	7003309,dt.31.10.2016	Sh. B.	Godinë shërbimi 1 kat
4.	7003203,dt.24.10.2016	A. H.	Godinë shërbimi 1 kat
5.	7003192,dt.24.10.2016	L. B.	Godinë shërbimi 1 kat
6.	7003183,dt.21.10.2016	E. M.	Godinë shërbimi 3 kat
7.	7003133,dt.21.10.2016	U. O.	Godinë banimi 2 kat
8.	7003181,dt.21.10.2016	G. C.	Godinë Social Ekonomik
9.	7003336,dt.01.11.2016	A.B.	Godinë ban.she shër.5 kt+papafingo+1kt.nt
10.	7003347,dt.08.11.2016	J.K.	Shtes anësore 3 kat, në Godinë ekz. 6 kat
11.	7003352,dt.08.11.2016	M. K.	Shtes anësore 3 kat, në Godinë ekz. 6 kat

(Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 9-16 të Raportit të Auditimit)

1.Rekomandimi: Drejtoritë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Tiranë Rurale Nr. 1 dhe Tiranë Rurale Nr. 2, të marrin masa duke plotësuar arkivin e institucionit me 11 dosjet që mungojnë, sipas lejeve të legalizimit të lëshuara, bazuar dhe në rakordimin e tyre me referencat përkatëse.

B. MASA DISIPLINORE

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.578/10, datë 23.12.2019, nuk është zbatuar rekomandimi, për dhënien e masës disiplinore për 18 punonjës, si vijon:

a. Masa “Nga Vërejtje deri në Largim nga puna (zgjidhje kontrate)”, për 8 punonjës si më poshtë:

1. **G. M.**, me detyrë ish Drejtor aktualisht specialist në Drejtorinë e Përgjithshme,
2. **E. B.** me detyrë ish përgjegjës sektori, aktualisht specialiste.
3. **B. J.**, me detyrë specialist,
4. **E. B.**, me detyrë specialist,
5. **D. M.**, me detyrë specialist,
6. **I. G.**, me detyrë jurist,
7. **G. M.**, me detyrë specialist,
8. **E. C.**, me detyrë specialist

b. Masa disiplinore “Vërejtje” për 10 punonjës si më poshtë:

1. **Z. K. H.**, me detyrë Specialist,
2. **Z. H. H.**, me detyrë Specialist,
3. **Z. S. B.**, me detyrë specialist,
4. **Z. M. B.**, me detyrë specialiste,
5. **Z. K. Q.**, me detyrë Specialist,
6. **Z. D. K.**, me detyrë Specialist,
7. **Z. G. Sh.**, me detyrë Specialist,
8. **Z. A. C.**, me detyrë Specialist,
9. **Z. G. S.**, me detyrë Specialist,
10. **Z. Xh. K.**, me detyrë Specialist

Për sa më sipër, për moszbatimin e rekomandimit, për dhënien e masave disiplinore punonjësve të mësipër, mbështetur në nenin 15, shkronja “c” të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “a” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, si dhe në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në kontratën individuale të punës **i rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më sipër dhe marrjen e masave disiplinore.

NË DREJTORINË VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, KAVAJË

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.577/9, datë 21.12.2019, nuk janë zbatuar rekomandimet si vijon:

Rekomandimi nr.6. “Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria 38/26/1, Golem, ZK 1791, për shkeljet e konstatuara:

- të marrë masa për sistemimin “shtet” të sipërfaqes të palegalizuar 250 m², ose për shitjen e saj poseduesit me çmimet e tregut apo dhënien me qira,

-të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar për pagesën e taksës infrastrukturës dhe parcelës ndërtimore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*)

Rekomandimi nr.7. “Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria nr. 3/312, ZK 8552, për shkeljet e konstatuara: të marrë masa për kufizimin e pasurisë deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të munguar në bashkëpunim me pushtetin vendor, për shtesën e ndërtimit prej 14 m²” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*).

rekomandimi **nr.13.** “Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për ndërtimin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria nr.14/389, ZK 8551, për shkeljet e konstatuara të sistemohet në “shtet” diferenca tepër e sipërfaqes 27,5 m² e zënë në mënyrë të paligjshme” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi nr.14. “Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria nr.2/304/2 dhe 2/304/1, “shtesën anësore 2-kat + ngritje 1–kat në godinën ekzistuese poçeria Kavajë”, ZK 8551, të marrë masa:

- të kalojë “shtet” sipërfaqen tepër 514 m², si diferencë midis sipërfaqes blerjes truallit (1998) dhe LN (2017), pasuria 2/304, ZK 8551, vol 13, faqe 247” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi nr.15. “Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria nr.1/89/1, ZK 8551, “godinë e kombinuar 2-kat”, për shkeljet e konstatuara të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar si me sipër” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*)

Rekomandimi nr.16. “Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria 482/17/1, ZK 3235, Rrogozhinë, për shkeljet e konstatuara, të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar, për marrëdhëniet pjesërisht me truallin, pasi një pjesë e sipërfaqes “arë” mbi të cilin është ngritur objekti është pronë e një personi tjetër, sipas KPP, pasuria 482/17, vol 10, faqe 224, ZK 3235” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*).

Rekomandimi nr.20. “Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, pasuria 456/33/4, ZK 3235, Rrogozhinë, për shkeljet e konstatuara, të rishikojë lejen e legalizimit, të plotësojë dokumentacionin tekniko-ligjor të munguar, në të kundërt të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes legalizimit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*)

Rekomandimi nr.22. “Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë, për 2 objektet informale të pajisura me leje legalizimi, pasuria 25/41/1, ZK 3501, Spille dhe pasuria nr. 72/24/1, ZK 3554, Synej, për shkeljet e konstatuara: të kufizohen pasuritë deri në zgjidhjen e marrëdhënieve për një pjesë me truallin, pasi është pasuri e të tretëve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*)

Rekomandimi nr.23. “Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, për shkeljet e konstatuara për pasurinë 5/385/2, ZK 8551, lagje 2, Kavajë, me sipërfaqe të parcelës ndërtimore 479,7 m² me sipërfaqe ndërtimi 289,5 m², të marrë masa: të rishqyrtojë lejen e legalizimit duke përcaktuar 300 m² parcelën ndërtimore nga 479,7 m² që ishte legalizuar (479,7 m²- 179,7), pasi diferenca e sipërfaqes 179,7 m² është pjesë e pasurisë 5/4” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*)

Rekomandimi nr.25. “Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kavajë për objektin informal të pajisur me leje legalizimi, për shkeljet e konstatuara për pasurinë 429/3/1, ZK 3235, Rrogozhinë, ndërtesë social-ekonomike 4-kat, të marrë masa që:

- të rishqyrtojë lejen e legalizimit duke verifikuar dhe siguruar dokumentacionin e duhur, në të kundërt të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejes legalizimit” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*)

Rekomandimi nr.30. “Titullari i DVASHK Kavajë, në rolin e drejtuesit të programit buxhetor, në fillim të planifikimit të nevojave për fonde buxhetore të marri masat e nevojshme duke krijuar ekipin e menaxhimit të programit, si dhe përcaktimin e nëpunësit zbatues të DVASHK Kavajë, në rolin e sekretarit të grupit për hartimin e projekt-buxhetit afat-mesëm dhe atij vjetor. Gjithashtu procedura e përgatitjes së buxhetit të sigurojë gjurmët e auditimit, ku çdo anëtar i grupit të menaxhimit të programit të dokumentojë me shkresë përcjellëse drejtuar sekretarit të grupit, kërkesat për fondet buxhetore, për strukturën që është përgjegjëse” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit*)

Rekomandimi nr.36. “Nga titullari i DVASHK Kavajë, të merren masat e nevojshme për sistemimin e diferencave të aktiveve, të rezultuara nga procesi i inventarizimit, si dhe të bëhet kontabilizimi i

saktë i tyre në pasqyrat financiare, sipas llogarive përkatëse. Gjithashtu çdo komision inventarizimi për çdo diferencë që rezulton nga inventarizimi i aktiveve me vlerën e tyre në kartelat përkatëse të mbajë procesverbal dhe në fund të procesit të hartojë raportin e inventarizimit për nivelin drejtues të institucionit” (Më hollësisht trajtuar në pikën 4 faqe 10-18 të Raportit të Auditimit)

1.1.Rekomandim:DVASHK Kavajë në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, për rekomandimet e pa zbatuara, të marrë masat e nevojshme, rast pas rasti, duke vendosur/hequr masën e kufizimit, dhe (ose) shfuqizimin e plotë/pjesor të lejeve të legalizimit, rivlerësimin edhe një herë të dokumentacionit tekniko-ligjor, likuidimin e parcelës ndërtimore, krijuar ekipin e menaxhimit të programit, si dhe përcaktimin e nëpunësit zbatues të DVASHK Kavajë, në rolin e sekretarit të grupit për hartimin e projekt-buxhetit afat-mesëm dhe atij vjetor, sistemimin e diferencave të aktiveve, të rezultuara nga procesi i inventarizimit, si dhe të bëhet kontabilizimi i saktë i tyre në pasqyrat financiare, sipas llogarive përkatëse.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2021 dhe në vijimësi

B.MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.577/9, datë 21.12.2019, nuk është zbatuar rekomandimi nr.1, si vijon:

▪ “Titullari i DVASHK Kavajë të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **384,000 lekë nga subjekti përfitues**” (Më hollësisht trajtuar në pikën 5 faqe 18-19 të Raportit të Auditimit)

1.Rekomandim: Titullari i DVASHK Kavajë të marrë masat e nevojshme duke analizuar situatën dhe të identifikojë përgjegjësit, si dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **384,000 lekë nga subjekti përfitues**.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2021 dhe në vijimësi

NË ZYRËN VENDORE TË AGJENCISË SHTETËRORE TË KADASTRËS, DEVOLL

A. MBI REKOMANDIMET E PAPERANUARA

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve të kryer pranë 6 subjekteve të auditimit, u konstatua se në subjektin Zyra Vendore e ASHK-së Devoll, nuk janë pranuar 14 rekomandime, për të cilat gjykojmë të rivlerësohet me objektivitet nga ZVASHK Devoll, DVASHK Korçë, dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së, masat e rekomanduara, efekti që sjellin, dhe problematika që limiton zbatimin e tyre.

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.579/9, datë 27.12.2019, nuk janë zbatuar rekomandimet, si vijon:

▪ **Rekomandimi nr.7.** Titullari i ZVASHK Devoll të marrë masa të nxjerrë urdhrin përkatës në zbatim të AMTP nr.30 (që përcakton vetëm një pasuri dhe jo dy, me sipërfaqe 7680 m²) dhe të kryejë veprimet për bashkimin e KPP-ve të çelura gabim nga NJMP përkatësisht: KPP v.5, f. 118 ZK 2657 Menkulas me sipërfaqe 7680 m² AMTP dhe 2947 m²LN dhe KPP pasurinë v. 5, f. 119, ZK 2657 Menkulas me sipërfaqe 7680 m²AMTP dhe 4062 m²LN në një KPP të vetme me sipërfaqe 7680 m² AMTP dhe LN 7009 m² (2947+4062) m², pasi është dyfishuar sipërfaqja e dhënë sipas ligjit, pra 7680 m² është 2 herë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).

▪ **Rekomandimi nr.15.** Titullari i ZVASHK Devoll të marrë masa të rishqyrtojë referencën nr. 6527 datë 04.10.2017 për lejen e legalizimit nr.160933, datë 24.07.2017 si dhe në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 datë 07.02.2018 “Për Kadastrën”, të nxjerrë dhe regjistrojë hipotekë ligjore mbi pasurinë nr.1/66 ND, v.21, f.43 zk.1187 Bilisht Qytet me sip truall e ndërtesë 38,5 m², deri në përcaktimin e

zgjdhjen marrëdhënies me truallin si në lejen e legalizimit ashtu dhe në KPP (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).

▪ **Rekomandimi nr.17.** Titullari i ZVASHK Devoll të marrë masa të inventarizojë dokumentacionin përkatës të 12 dosjeve referenca të periudhës 2017-31.08.2019 praktika të regjistrimeve të pasurive me Vendime Gjykate (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).

▪ **Rekomandimi nr.23.** Titullari i ZVASHK Devoll të rishqyrtojë referencën nr.6750, datë 30.04.2019, aplikim nr. 931, datë 18.04.2019, të Bashkisë Devoll, bëjë identifikimin e gjendjes juridike fizike pasqyruar në KPP për tri pasuritë nr.1/10, nr.1/28 dhe nr. 1/33 si pjesë e 5 pasurive me sipërfaqe totale truall me sipërfaqe 7988 m² ndodhur në lagjen SMT Bashki Devoll prej të cilave janë identifikuar 2 pasuri me sipërfaqe 1981 m² (875+1060), pra të identifikohet sipërfaqja prej 6007 m² (7988-1981) që u përket 3 pasurive; si dhe të jepet informacioni Bashkisë Devoll (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).

▪ **Rekomandimi nr.29.** Titullari i ZVASHK Devoll, të marrë masa të rishqyrtojë e japë informacion Bashkisë Devoll për gjendjen juridike fizike të KPP-ve të sistemeve të 3 ujësjellësve përkatësisht: objektit “Ujësjellësit të Fshatit Tren zk. 3637”, objektit “Ujësjellësit Fshatit Hocisht zk. 1955” dhe objektit “Ujësjellësit Fshatit Bitinckë zk. 1202”; si dhe të regjistrojë e lëshojë certifikata përkatëse Bashkisë Devoll për rreth 15 pasuritë sipas 3 referencave: 1. referenca nr. 2488 që i përket pasurive të Ujësjellësit të Fshatit Tren zk.3637, 2. referenca nr. 873 që i përket pasurive të Ujësjellësit Fshatit Hocisht zk. 1955, 3. referenca nr. 486 që i përket pasurive të Ujësjellësit Fshatit Bitinckë zk.1202, transferuar në pronësi të ish Komunave sipas VKM-ve përkatëse, aktualisht në pronësi të Bashkisë Devoll (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).

▪ **Rekomandimi nr. 30.1.** Titullari i ZVASHK Devoll të marrë masa të identifikojë e çelë KPP-të për rezervuarin Koshnicë 2, me 32000 m² sipërfaqe ujore teknike (truall për të cilin nuk është çelur KPP nga NJMP) me Digën e aksesorët përkatës skemat ujitëse, rrjetet e Kanaleve të sipërm, kanalit shkarkues e të kanalit kryesor shpërndarës etj.

▪ **Rekomandimi nr.30.2.** Titullari i ZVASHK Devoll të marrë masa të identifikojë e japë informacion për gjendjen e KPP-ve të rezervuarve, të regjistrojë pronat publike të llojit rezervuar me Digat përkatëse, me skemat ujitëse, aksesoret përkatës rrjetet e Kanaleve të sipërm, shkarkues, kanalit kryesor shpërndarës etj, dhe të kërkojë në rrugë zyrtare nga Bashkia Devoll për aplikimin dhe regjistrimin e 22 rezervuarve prej tyre për 21 janë çelur KPP-të, prej të cilëve: për 8 rezervuar të regjistruar në emër të Bordit të kullimit Korçë (por që duhet që Bashkia Devoll të aplikonte për kalimin në emër të sipas VKM nr.510, datë 10.06.2015) dhe për 14 rezervuar që nuk janë regjistruar nga ish- Komunitat (por që edhe këto 14 rezervuar tashmë të transferuar Bashkia Devoll duhej ti regjistronte në emër të saj), në përmbushje të detyrimit sipas pikave 6,7 të VKM nr.567, VKM nr.1157 dhe të VKM nr. 510, datë 10.06.2015 (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).

▪ **Rekomandimi nr.31.** Titullari i ZVASHK Devoll, të marrë masa të identifikojë gjendjen juridike fizike dhe të çelë KPP-të përkatëse dhe si prona të paluajtshme sende objekte komplekse të evidentojë aksesorët përkatës, pjesë të skemave ujitëse, si kanale kryesore, të betonuar, kanalet e ujërave të larta, pika shpërndarje uji, shkarkuesit, pika të sifonëve, me sisteme tubacioni, stacione pompimi etj, Digat, pra të këtyre aksesorëve me trojet përkatëse të sipërfaqeve për të 22 rezervuarët shtrirë në territorin, juridiksinin dhe në pronësi të Bashkisë Devoll (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).

▪ **Rekomandimi nr.33.** ZVASHK Devoll në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, për shkeljet konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi për 6 pasuritë “truall” përkatësisht: nr. 258/4, nr. 112/136, nr. 112/101, nr. 253/14, nr. 253/13 dhe nr. 106/33, me sipërfaqe 880 m², deri në saktësimin e listave 0001, ZK 3637 “Tren”, në bashkëpunim me Bashkinë Bilisht, në të kundërt të veçojë regjistrimin “shtet”, të sipërfaqeve tepër, ndërsa për pasurinë e shitur nr. 258/4 të zhdëmtohet vlera 350,000 lekë nga pronari i parë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit)

- **Rekomandimi nr.34.** ZVASHK Devoll në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, për shkeljet konstatuara të vendosë masë kufizimi deri sa të verifikojë vlefshmërinë e AMTP-ve duke plotësuar dokumentacionin tekniko-ligjor, të plotësohet KPP me datën përfundimtare, me vulën dhe nënshkrimin e Regjistruarit, për pasurinë 440/29, ZK 3637 “Tren” vol 9, faqe 117, të pasqyrohet emri i pronarit tek seksioni “C” i KPP, vol 6, faqe 163, ZK 3637 “Tren”, për pasurinë 38/67, 1200 m² arë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).
- **Rekomandimi nr.35.** ZVASHK Devoll në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, për shkeljet e konstatuara: të marrë masa për hartimin e një udhëzimi të posaçëm për 6 rastet e mësipërme si dhe të plotësohet KPP me datën përfundimtare, me vulën dhe nënshkrimin e Regjistruarit, për 6 pasuritë nr. 448/17, 307/7, 19/1, 54/19, 218/17 dhe 28/30, ZK 3637 “Tren” vol 3, faqe 19-24 (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).
- **Rekomandimi nr.37.** Zyra Vendore ASHK Devoll në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 “Për Kadastrën”, për shkeljet konstatuara: të nxjerrë urdhrin e kufizimit për pasurinë nr. 637/9, ZK 3822, vol 12, faqe 110, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).
- **Rekomandimi nr.40.2.** Të anulohet ndryshimin e zërit kadastral nga “shkëmb” në “PF”, si të paargumentuar me dokumente dhe pa mbështetje ligjore, siç ishte më parë statusi juridik i tyre, për: pasurinë 364 “kullotë”, ZK 3637, vol 9, faqe 163; pasurinë 357, “shkëmbore”, ZK 1202, vol 1, faqe 50 dhe vol 23, faqe 142-143; pasurinë 384, “shkëmbore”, ZK 1202, vol 1, faqe 60 (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit)
- **Rekomandimi nr.41.** Zyra Vendore ASHK Devoll në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, për shkeljet e konstatuara: të sistemojë dhe pasqyrojë në një KPP, ZK 1202, pasurinë 482/10, vol 10, faqe 94 dhe pasurinë 482/10 ND, vol 23, faqe 124, referencë 2656; të anulohet regjistrimin në seksionin B të pasurisë 497/6 “are+truall”, 580 m² (285 m² truall) duke e pasqyruar pasurinë 497/6 “are” 580 m², pasi është regjistruar njëherë tek pasuria 482/10 ”arë + truall”, 4800 m² (285 truall dhe 91 ndërtesë), vol 10, faqe 92 dhe 94, ZK 1202, Bitinckë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).
- **Rekomandimi nr.46.** Zyra Vendore ASHK Devoll në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, për shkeljet e konstatuara, të nxjerrë urdhër kufizimi dhe të kufizojë në seksionin “E” pasurinë 6/815 ND, ZK 1187, Bilisht, vol 21, faqe 7, deri në plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për kalimin e të drejtës pronësisë mbi parcelën ndërtimore dhe 2 mandat pagesat origjinale për shlyerjen e detyrimeve (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).
- **Rekomandimi nr.47.** Titullari i ZVASHK Devoll të marrë masa, në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasurinë deri në plotësimin e dokumentacionit të kërkuar konkretisht procesverbali i marrjes në dorëzim të pronës në tërësi (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).
- **Rekomandimi nr.52.** Titullari i ZVASHK Devoll të marrë masa, në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara dhe në dispozitat ligjore përkatëse, të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë e cituara më sipër për regjistrimin e lejes së ndërtimit për zbatimin e Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr.5, datë 29.12.2014 “Për identifikimin e zonave të urbanizuara në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe në miratimin e hartave ku mund të ndërhyjë në funksion të zhvillimit urban”, pika 9 ku përcaktohet: “Konvertimi nga tokë “Arë” në tokë “Truall” për sipërfaqet brenda zonave të urbanizuara do të bëhet sipas procedurave përkatëse, në përputhje me legjislationin në fuqi”. Ky ndryshim do të behet pranë ZVRPP me kërkesë të pronarit dhe kërkesë të bashkisë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 12-27 të Raportit të Auditimit).

1.Rekomandim: ZVASHK Devoll në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të ASHK-së Korçë, për rekomandimet e pa zbatuara, të marrë masat e nevojshme, rast pas rasti, duke vendosur/hequr masën e kufizimit, dhe (ose) shfuqizimin e plotë/pjesor të lejeve të legalizimit, rivlerësimin edhe një herë të

dokumentacionit tekniko-ligjor, likujdimin e parcelës ndërtimore, inventarizojë dokumentacionin përkatës të dosjeve të periudhës 2017-31.08.2019, çelë KPP-të përkatëse dhe hartimin e një udhëzimi të posaçëm për 6 rastet e mësipërme.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2021 dhe në vijimësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.579/9, datë 27.12.2019, nuk janë zbatuar rekomandimet, si vijon:

▪ **Rekomandimi nr.1.** ZVASHK Devoll për diferencat e shkelje të konstatuara, në objektin “Rikonstruksion i ambienteve të ZVRPP Devoll”, të marrë masa për arkëtimin e vlerës 80,155 lekë, përkatësisht: vlera 49,814 lekë (22,305 + 27,509), nga “L” shpk, për diferenca në 4 zëra punimesh të pakryera dhe tvsh përfituar padrejtësisht për zërin “paisje hidrosanitare”; vlera 19,841 lekë, nga E. M., për rritje artificiale të vlerës preventivit; vlera 10,500 lekë (398,000 lekë - 387,500 lekë), diferencë midis firmës fituese dhe OE të renditur pas tij, nga titullari i AK dhe KVO, Z. S., F. A., M. A., B. J. (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 27-28 të Raportit të Auditimit).

▪ **Rekomandimi nr.3.** ZVASHK Devoll në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, për mangësitë e konstatuara: të vendosë masë kufizimi për pasurinë 203/122 ND, vol 14, faqe 72, ZK 3822, deri në shlyerjen e taksës infrastrukturës në vlerën 470,760 lekë; të anulojë bashkimin e pasurisë mëmë 203/122, sipërfaqe 6400 m², vol 14, faqe 15, ZK 3822, duke i lënë pasuritë bija në vete siç ishin më parë, përkatësisht: pasuria 203/116 , vol 13, faqe 42 dhe pasuria 203/109, vol 5, faqe 28, pasi kanë probleme me hartografinë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 27-28 të Raportit të Auditimit).

▪ **Rekomandimi nr.4.** Titullari i ZVASHK Devoll të marrë masa në bazë të nenit 27 të ligjit 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”, bazuar në shkeljet e konstatuara të nxjerrë urdhër kufizimi për pasuritë dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore, për arkëtimin e dëmit të shkaktuar, si vijon: diferencën midis vlerës së preventivit dhe situacionit (17,426,798 - 15,658,609 = 1,768,139 x 4 % = 70,727 lekë (Më hollësisht trajtuar në pikën 4, faqe 27-28 të Raportit të Auditimit).

1.Rekomandimi: ZVASHK Devoll në bashkëpunim me DVASHK Korçë, të marrë masat e nevojshme, të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, vendosjen e masës së kufizimit, për arkëtimin e vlerës **621,642 lekë gjithsej**, sipas rasteve më sipër.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.579/9, datë 27.12.2019, **nuk është zbatuar rekomandimi**, për dhënien e masës disiplinore “**Vërejtje**” ndaj 3 punonjësve, si vijon:

1. z. B. J., me detyrë jurist.

2. z. O. F., me detyrë jurist.

3. zj. E. M., me detyrë specialiste sektori hartografisë.

Për sa më sipër, për moszbatimin e rekomandimit, për dhënien e masave disiplinore punonjësve të mësipër, mbështetur në nenin 15, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat “e” dhe “ç” të nenit 1, kreun IV, dhe nenet 37 dhe 144 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996, ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr.136/2015, Ligjit nr. 33, datë 29.04.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”, si dhe në kontratën individuale të punës, **i rikërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për punonjësit e mësipërm.

NË AGJENCINË KOMBËTARE TË MJEDISIT, TIRANË

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.401/8, datë 02.10.2019, nuk janë zbatuar rekomandimet, si vijon:

- **Rekomandimi nr.1.** Titullari i AKM-së të marrë masat e nevojshme që në çdo vit të përgatisë deklaratën dhe raportin e kontrollit të cilësisë, dhe t'ia përcjelli Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, si institucion epror i saj (*Më hollësisht trajtuar në pikën (4) faqe (6-12) të Raportit të Auditimit*).
- **Rekomandimi nr.14.** AKM në zbatim të pikës 1/b.i, dhe pikës 3 neni 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, të marrë masa dhe të rillogarisë detyrimin finciar sipas kritereve ligjore, si dhe të bashkëpunojë me ISHPMU, për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes nga subjekti privat, duke konkluduar me vendosjen e penaltetit për "P. M." shpk, në vlerën rreth 3,900,000 lekë, ti propozojë Ministrit të MTM-së për revokimin e lejes mjedisore, si pasojë e mos përmbushjes të kushteve të lejes mjedisore nga subjekti (*Më hollësisht trajtuar në pikën (4) faqe (6-12) të Raportit të Auditimit*).
- **Rekomandimi nr.15.** AKM në zbatim të pikës 1/b.i, dhe pikës 3 neni 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, të marrë masa dhe të rillogarisë detyrimin finciar sipas kritereve ligjore, si dhe të bashkëpunojë me ISHPMU, për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes nga subjekti privat, duke konkluduar me vendosjen e penaltetit për 8 subjektet "E.", "V.", "A.", ".", "F..", "B. G.", "T." dhe "R." sipas vlerave përkatëse, ti propozojë Ministrit të MTM-së për revokimin e lejes mjedisore, si pasojë e mos përmbushjes të kushteve të lejes mjedisore nga subjektet (*Më hollësisht trajtuar në pikën (4) faqe (6-12) të Raportit të Auditimit*).
- **Rekomandimi nr.16.** AKM në zbatim të pikës 1/b.i, dhe pikës 3 neni 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, të marrë masa dhe të rillogarisë detyrimin finciar sipas kritereve ligjore, si dhe të bashkëpunojë me ISHPMU, për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes nga subjekti privat, duke konkluduar me vendosjen e penaltetit për 6 subjektet "E.", "Z.ZZ" shpk, "3P ." shpk, "V." shpk, "D.T." shpk, "P. D." shpk dhe "A." shpk, sipas vlerave përkatëse, ti propozojë Ministrit të MTM-së për revokimin e lejes mjedisore, si pasojë e mos përmbushjes të kushteve të lejes mjedisore nga subjektet (*Më hollësisht trajtuar në pikën (4) faqe (6-12) të Raportit të Auditimit*).
- **Rekomandimi nr.17.** AKM të marrë masa për fillimin e procedurave, për revokimin e lejes mjedisore në zbatim të nenit 27 të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” ndaj subjektit “A.”, pajisur me Leje Mjedisore Tipi B, me nr. Identifikimi të Lejes 2313, sipas Akt-miratimit nr.5595, datë 01.09.2016 (*Më hollësisht trajtuar në pikën (4) faqe (6-12) të Raportit të Auditimit*).
- **Rekomandimi nr.21.** Drejtori i Përgjithshëm i AKM të marrë masa, në bazë të VKM nr.142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, si dhe bazuar në shkeljet e konstatuara të informojë DAP që këto vende të plotësohen me punonjës që fusha dhe niveli i studimit të përshtaten me fushën e specialitetit të vendit të punës. Të shihet mundësia që punonjësit e mësipërm të përshtaten në vende me përshkrim pune të njëjtë me fushën e arsimimit të tyre pranë AKM (*Më hollësisht trajtuar në pikën (4) faqe (6-12) të Raportit të Auditimit*).

1.Rekomandim: Titullari i AKM-së për rekomandimet e pa zbatuara, referuar ndryshimeve të funksioneve të institucionit, duke u shtuar edhe funksioni i inspektimit, të marrë masat e nevojshme, rast pas rasti (revokim të lejes mjedisore, vendosje të penaltetit, ripozicionimin e punonjësve sipas formimit të tyre arsimor, etj), me qëllim përshpejtimin e procesit, për zbatimin e tyre.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2021 dhe në vijimësi

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.401/8, datë 02.10.2019, nuk është zbatuar rekomandimi, si vijon:

- **Rekomandimi nr.1.** AKM në zbatim të pikës 1/b.i, dhe pikës 3 neni 29, të Ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar, të marrë masa dhe të rillogarisë detyrimin finciar sipas kritereve ligjore, si dhe të bashkëpunojë me ISHPMU, për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes nga subjekti privat, duke konkluduar me vendosjen e penaltetit për "I." shpk dhe "A." shpk sipas vlerave përkatëse, ti propozojë Ministrit të MTM-së për revokimin e lejes mjedisore, si pasojë e mos

përbushjes të kushteve të lejes mjedisore nga subjekte, si dhe të kërkojë në rrugë administrative dhe gjyqësore arkëtimin e vlerës **1,200,000 lekë, e ndarë respektivisht në 720,000 lekë për "I." shpk dhe 420,000 lekë për "A." shpk** si të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit (*Më hollësisht trajtuar në pikën (5) faqe (12-15) të Raportit të Auditimit*).

1.Rekomandim: Titullari i AKM-së, referuar ndryshimeve të funksioneve të institucionit, duke u shtuar edhe funksioni i inspektimit, të marrë masat e nevojshme dhe të rillogarisë detyrimin financiar sipas kriteve ligjore, për vlerësimin e rëndësisë së shkeljes nga subjekti privat, duke konkluduar me vendosjen e penalitetit për "I." shpk dhe "A." shpk sipas vlerave përkatëse, ti propozojë Ministrin të MTM-së për revokimin e lejes mjedisore, si pasojë e mos përbushjes të kushteve të lejes mjedisore nga subjekte, si dhe të kërkojë në rrugë administrative dhe gjyqësore arkëtimin e vlerës **1,200,000 lekë, e ndarë respektivisht në 720,000 lekë për "I." shpk dhe 420,000 lekë për "A." shpk** si të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit.

Brenda 3-mujorit të parë të vitit 2021

C. MASA DISIPLINORE

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve përcjellë me shkresën nr.401/8, datë 02.10.2019, nuk është zbatuar rekomandimi, për dhënien e masës disiplinore ndaj 20 punonjësve, si vijon:

1. **DD** (Drejtoreshë e Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse).
2. **NP**, (Drejtor i Informacionit dhe Statistikave).
3. **BT**, (Përgjegjëse e sektorit të lejeve mjedisore).
4. **EM**, (Përgjegjëse e sektorit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis).
5. **BH**(Përgjegjës i sektorit të inventarit kombëtar të pyjeve).
6. **VGj** (Përgjegjëse e sektorit të laboratorit).
7. **EM**, (Përgjegjëse e Sektorit Regjistrat Shkarkimeve dhe transferimit të Mbetjeve).
8. **RS**, (Përgjegjese sektori Finance).
9. **AC** (Specialist në sektorin e Lejeve Mjedisore)
10. **KS** (Specialist në sektorin e Lejeve Mjedisore)
11. **AP**, (Specialiste në sektorin e Lejeve Mjedisore).
12. **BK**, (Specialiste në sektorin e Përgjegjësisë Mjedisore).
13. **AP**, (Specialist në sektorin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis).
14. **JM** (Specialiste në sektorin e Lejeve Mjedisore).
15. **EM**, (Specialiste në sektorin e Përgjegjësisë Mjedisore).
16. **RK** (Specialiste në sektorin e Lejeve Mjedisore).
17. **BH** (specialist i sektorit të silvikulturës në AKM).
18. **EI** (specialist i sektorit të inventarit të pyjeve në AKM).
19. **Sh. Sh.** (specialist i sektorit të inventarit të pyjeve në AKM).
20. **Gj. F.** (Specialiste në sektorin e laboratorit).

Për sa më sipër, për moszbatimin e rekomandimit nga Drejtori i Përgjithshëm i AKM-së, për dhënien e masave disiplinore punonjësve të mësipër, mbështetur në nenin 15, shkronja "c" të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në nenin 57 "Përgjegjësia për masat disiplinore", nenin 58 "Llojet e masave disiplinore", dhe nenin 59 "Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore" të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", VKM nr. 115, datë 05.06.2014 "Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil", **i kërkojmë Ministrin të Ministrisë së Mjedisit dhe Turizmit**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë dhe fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore për:

1. Z. E. K., me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i AKM-së, për moszbatimin e rekomandimit të lënë në auditimin e mëparshëm të kryer nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Administrimit të Aseteve dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë.

KRYETARI

Arben SHEHU